

**"KASTRATI" SHA
NUIS L92221506G**

Lagja 14, Rruga "Tiranës", ura e "Dajlanit", Durrës

Datë: 03.06.2022

VENDIM

I

AKSIONARIT TË VETËM

Shoqëria "KASTRATI" SHA është regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 21.10.2019, me nr. NIPT L92221506G. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë.

Aksionar i vetëm i shoqërisë është **Z. Shefqet KASTRATI**, zotërues i 100 % të aksioneve të kapitalit themeltar.

Aksionari i Vetëm i shoqërisë, bazuar në tagrat që i njeh statuti dhe ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar,

VENDOSI:

- Të miratojë nënshkrimin me z. Theodhoro Çami, të marrëveshjes për revokimin e kontratës së datës 11.04.2022, për blerjen e 60% të kapitalit të shoqërisë "INTER MEDIA GROUP" SHPK (NUIS L61429018R) si dhe revokimin e "marrëveshjes së ortakëve" të së njëjtës datë.**
- Autorizohet administratorja e shoqërisë "KASTRATI" SHA, Znj. Eda Spahiu të nënshkruajë marrëveshjen e sipërcituar. Znj. Eda Spahiu ka të gjitha të drejtat në lidhje me negocimin e termave të marrëveshjes, pa asnjë përjashtim.**

"KASTRATI" SHA

AKSIONARI I VETËM

SHEFQET KASTRATI

[emër, mbiemër, firmë, vulezim]




MARRËVESHJE

(PËR REVOKIM KONTRATE SHITJE KUOTASH)

Sot më datë **06.06.2022**, nënshkruhet kjo "MARRËVESHJE PËR REVOKIM KONTRATE SHITJE KUOTASH" si më poshtë vijon:

DISPOZITA PARAPRAKE:

- a. Më datë **11.04.2022**, z. Theodhoro Çami në cilësinë e Shitësit dhe "Kastrati" SHA në cilësinë e Blerësit, kanë nënshkruar një kontratë për shitjen e 60% të kapitalit të shoqërisë "Inter Media Group" SHPK (NUIS L61429018R) [*Kontrata e shitjes së kuotave bashkëngjitur kësaj marrëveshje dhe pjesë integrale e kësaj të fundit*];
- b. Referuar kontratës, çmimi për shitjen e 60% të kapitalit, në vlerën prej 2,371,000 EUR, do të paguhej prej Blerësit brenda një afati kohor 3 mujor nga data e nënshkrimit të kontratës, çmim i cili ende nuk ka filluar të paguhet;
- c. Pavarësisht mënyrës dhe afatit për pagesën e çmimit, Blerësi me nënshkrimin e kontratës së shitjes së kuotës, u shndërrua në pronar të 60% të kapitalit të shoqërisë "Inter Media Group" SHPK;
- d. Në vijim të nënshkrimit të kontratës për shitjen e kuotave të datës 11.04.2022, palët nënshkruan me njëra-tjetër edhe një "marrëveshje ortakësh" (datë 11.04.2022), në përputhje me të cilën Blerësi (Kastrati SHA) merrte përsipër të investonte në shoqëri (Inter Media Group SHPK), edhe një vlerë shtesë monetare;
- e. Palët e cituara në pikën a) më sipër, kanë vendosur me vullnet të lirë e të plotë që të revokojnë kontratën e shitjes së kuotave të datës 11.04.2022 si dhe marrëveshjen e cituar në pikën d) më sipër, duke rënë dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje revokimi, si më poshtë vijon:



Neni 1

Palët në këtë Marrëveshje

- 1) Z. **Theodhoro Çami**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastër, më datë 06.09.1981, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër I10906013F, nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**".
dhe
2) Shoqëria "**KASTRATI SHA**", me NUIS L92221506G, nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**", përfaqësuar nga Administratorja **Znj. Eda Spahiu**.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

- 2.1. Objekti i kësaj marrëveshje, është revokimi (shfuqizimi) i kontratës së shitjes së kuotave të datës 11.04.2022, nëpërmjet së cilës Shitësi (z. Theodhoro Çami) transferoi nëpërmjet shitjes kundrejt Blerësit (Kastrati SHA), **60% (gjashtëdhjetë përqind)** të kapitalit të shoqërisë "INTER MEDIA GROUP" SHPK (NUIS L61429018R).
- 2.2. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, edhe marrëveshja tjetër (cituar në pikën d. të dispozitave paraprake), konsiderohet prej palëve si plotësisht e revokuar dhe pa asnjë pasojë ligjore.

Neni 3

Pasojat e revokimit

- 3.1. Me revokimin (shfuqizimin) e kontratës së shitjes së kuotave të datës 11.04.2022, palët kthehen në gjendjen e mëparshme, pra në gjendjen përpara transferimit të kuotave. Për të evituar çdo dykuptimësi, Shitësi (z. Theodhoro Çami) ri-bëhet zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë "Inter Media Group" SHPK, duke zotëruar 1 (një) kuotë me vlerë nominale 31.138.500 lekë.
- 3.2. Nga ana tjetër, Blerësi (Kastrati SHA), me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, zhvishet nga pronësia mbi 60% të kapitalit të shoqërisë "Inter Media Group" SHPK, si dhe nga çdo e drejtë apo detyrim tjetër i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me zotërimin e mëparshëm të kuotës.

Neni 4

Të drejta dhe detyrime të palëve

- 4.1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, palët deklarojnë se nuk kanë dhe nuk do të kenë në të ardhmen, kundrejt njëra-tjetrës, asnjë detyrim apo pretendim të çdo lloj

natyre, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me kontratën për shitjen e kuotave të datës 11.04.2022 dhe marrëveshjen e ortakëve të së njëjtës datë.

4.2. Për këtë qëllim, Shitësi deklaron me përgjegjësi të plotë ligjore se nuk ka dhe nuk do të ketë ndër të tjera, asnjë pretendim për pagesë në lidhje me transferimin e kuotës, ashtu sikurse Blerësi zotohet që nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim të lidhur me pronësinë mbi kapitalin e shoqërisë "Inter Media Group" SHPK si dhe të drejta të tjera derivuese të tilla si por pa u kufizuar në: pjesëmarrje në fitime, dividende, të ardhura të arkëtueshme etj.

4.3. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, Shitësi (z.Theodhoro Çami) rishndërrohet në pronar të vetëm dhe me të drejta ta plota të kuotës/kapitalit të shoqërisë "Inter Media Group" SHPK, ndërsa Blerësi (Kastrati SHA) zhvishet nga çdo përgjegjësi vijuese e marrë përsipër në përputhje me kontratën e shitjes së kuotave të datës 11.04.2022 dhe marrëveshjen e ortakëve të së njëjtës datë.

Neni 5

Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

5.1. Kjo marrëveshje përgatitet në 2 kopje, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë marrëveshje do të marrë një kopje të saj.

5.2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe fillon efektet e saj menjëherë me nënshkrimin e saj prej palëve.

5.3. Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje, palët do të bëjnë përpjekje maksimale për zgjidhje me mirëkuptim, në rast të kundërt, kompetente do të jetë Gj.Rr.Gj.Tiranë.

Z. Theodhoro ÇAMI

[emër, mbiemër, firmë]

KASTRATI SHA

Përfaqësuar nga

Eda Spahiu

Administratore

Eda Spahiu



[emër, mbiemër, firme, vulez shqetësuar nga]